



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.205/22

**GJYKATA KOMERCIALE** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Sh.... Sh.p.k me seli në Gjakovë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokat Zyhdi Axhemi nga prishtina,kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, vlerësim doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1972/17, të datës 16.01.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Sh.... Sh.p.k me seli në Gjakovë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.1972/17, të datës 16.01.2020, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.1972/17, të datës 16.01.2020, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.... Sh.p.k me seli në Gjakovë, ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi nr.01.3.2.2/666 dhe 668, i datës 13.10.2017, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat Zyhdi Axhemi, nga Prishtina, për shkak të: shqyrtimit dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike që ka rezultuar në zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë pas shqyrtimit të shkresave zyrtare të lëndës të vendos në mënyrë meritore eventualisht ta kthejë çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe

Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/666 dhe 668, i datës 13.10.2017, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë Sh.... Sh.p.k me seli në Gjakovë, për rishqyrtimin e vendimeve R-.... të datës 15.09.2017 dhe R-.... të datës 26.09.2017, të Zyrës së Brendshme Doganore Prizren.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 21.11.2017, me pretendim se i njëjti është i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/666 dhe 668, i datës 13.10.2017, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se gjykata nuk ka mundur që të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata e shkallës së parë konstaton se aktvendimi i kontestuar është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare gjeti se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës të LKA-së, dhe KDAK-së, sepse gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka nxjerr prova të mjaftueshme.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerr prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se

pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmojë provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të KDAK-së. Pasi që për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 të KDAK-së, në këtë rast paditësi është dashur që të dëshmojë vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit - eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar gjykatës prova materiale si faturën e mallit, kontratën e shitjes, deklaratën eksportuese, vlera e pagesave bankare njëra në shumë prej 7,200.00€ dhe tjetra 16,800.00€, nuk harmonizohet me vlerën e deklaruar sipas faturave përcjellëse të mallit. Prandaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur i ka pranuar konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pa pranueshme, pasi që në shkresat e lëndës mungon transferi bankar, andaj vlera e mallit e deklaruar nga subjekti nuk paraqet vlerën reale të mallit për qëllime doganore. Andaj aktvendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me nenin 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht sipas të dhënave me të cilat disponon Dogana e Kosovës, pra është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjen se gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur fakte të bazuara që argumentojnë se paditësi i ka paguar eksportuesit vlerën reale të mallit lëndor sipas faturave përcjellëse të mallit, pasi që nuk përputhet vlera e faturës me transferin bankar. Prandaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin kontestues ka konfirmuar rivlerësimin mallit lëndor nga pranimi qendror, duke aplikuar metodën e 6 të vlerësimit nga neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, përkatësisht të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, për mallin e njëjtë, dhe atë DUD-at R-.... të datës 15.09.2017 dhe R-.... të datës 26.09.2017. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe Kodit nr.03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË**  
**K.DH.SH.II.nr.205/22, me datë 10.11.2022**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Saranda Bogaj Sheremeti**